

## ARTIKULLI #12

# ZHVILLIMI BASHKËPUNUES I KURRIKULËS: UNIVERSITETI I IOWA DHE UNIVERSITETET PUBLIKE TË KOSOVËS BËJNË PARTNERITET ME LIDERË TË INDUSTRIJË

DECEMBER 10, 2023

Për më shumë foto mbi këtë artikull, shkoni në link:

<https://drive.google.com/drive/folders/1ZCu7Q9wPQXiALpAN1IXwfsR37JbGgG0J>



Figura 1: Punëtori e Panelit Korporativ mbajtur në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Universiteti i Prishtinës

Profesorë që specializojnë në arsim të bazuar në kompetencë në Universitetin e Iowa kanë bashkuar forcat me homologët e tyre nga universitetet publike në Kosovë për të udhëhequr punëtori që synojnë rishikimin e kurrikulave, si përgjigje ndaj informatave nga sektori privat. Duke filluar këtë Dhjetor, Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Pejës, dhe Universiteti i Prizrenit, me mbështetje të aktivitetit të financuar nga USAID *Partneritetet e Sektorit Privat për Forcimin e Arsimit të Lartë*, kanë dërguar ftesa për përfaqësues të kompanive lidere nga sektorët e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK) dhe Bujqësisë në Kosovë, duke nxitur bashkëpunim për përmirësimin e programeve universitare të studimit në këto sektorë. Ky aktivitet është mbështetur nga USAID dhe i zbatuar nga Universiteti i Iowa në partneritet me Universitetin Shtetëror të Iowa dhe Qendra për Arsim e Kosovës (KEC).

Profesorë nga universitetet në Kosovë shfrytëzuan strategjitë dhe praktikat e fituara gjatë një punëtorie paraprake të lehtësuar nga aktiviteti me titull “Trajnimi i Trajnerëve” i cili ishte dizajnuar të pajis stafin akademik të universiteteve me aftësitë për të udhëhequr panelet korporative. Këto panele korporative, të mbikëqyruara nga universitetet, janë ngjarje që mbahen nga secili fakultet në baza të rregullta. Liderë të industrisë nga sektorët relevant ftohen të kontribuojnë me njohuritë e tyre, duke ndihmuar në rafinimin e vazhdueshëm të kurrikulës për tu përputhur me nevojat dhe trendet më të fundit të tregut.



Figura 2: Punëtorja e Panelit Korporativ mbajtur në Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, Universiteti i Prizrenit

Profesorët morën një rol dëgjues gjatë këtyre punëtorive, duke lejuar profesionistët e industrisë të marrin rol kryesor. Përfaqësuesit nga industria prezantuan perspektivat e tyre mbi kompetencat e nevojshme për të diplomuarit, duke ofruar një pasqyrë të dorës së parë mbi aftësitë që kërkohen nga tregu i punës.

Punëtoritë e paneleve korporative që u mbajtën në Dhjetor 2023 shënojnë fillimin e një serie të punëtorive të lehtësuara nga aktiviteti, të cilat janë planifikuar në mënyrë strategjike për të përforcuar përpjekjet e universiteteve partnere në rishikimin dhe zhvillimin e kurrikulave. Këto punëtori shënojnë një partneritet novator mes universiteteve dhe bizneseve, të cilat synojnë të përforcojnë urën mes akademisë dhe kërkesave të industrisë.

**Visar Jasiqi, Udhëheqës i Inxhinierimit të Produkteve në Radix**, përfaqësues pjesëmarrës nga sektori privat i TIK, theksoi sfidat me të cilat përballen universitetet në përputhjen e kurrikulës me trendet dinamike në industrinë TIK. *“Në kontekst të peisazhit teknologjik që evoluon në mënyrë shumë të shpejtë, mendoj që është e rëndësishme të kultivohen mësimnxënës rezilient dhe të krijohet një bazament kurrikular i cili vë në theks adaptueshmërinë, të menduarit kritik, dhe aftësitë për zhvillim të zgjidhjeve, për të siguruar që të diplomuarit të mbesin konkurrues në fushën gjithnjë në ndryshim të TIK.”*



Figura 3: Punëtorja e Panelit Korporativ mbajtur në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Universiteti i Prishtinës

*"Punëtorja e panelit korporativ sot paraqiti diskutime të gjalla, aktivitete në grup, dhe prezantime shumë informuese nga përfaqësues të sektorit privat. Ky bashkëpunim me liderë të industrisë ofroi njohuri të vlefshme mbi nevojat dhe sfidat me të cilat përballen kompanitë e TIK dhe kërkesat e ardhshme për të diplomuarit tanë. Praktikant dhe teknikat e mësuara gjatë trajnimit të muajit të kaluar për panelin korporativ për profesorë kanë qenë shumë të dobishme, duke na ofruar ide të freskëta për të adaptuar konsultimet tona me partnerë të sektorit privat. Sot ishte një mundësi shumë e mirë për ne që të vëmë ato mësimet në praktikë dhe të rishikojmë kurrikulën në mënyra që janë efektive, angazhuese, dhe efektive për interesat më të mira të së ardhmës së studentëve tanë." Dhurata Hyseni- Ass. Profesoreshë në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Universiteti i Prishtinës.*

Kjo përpjekje bashkëpunuese mes institucioneve akademike dhe liderëve të industrisë ilustron një qasje proaktive për të adresuar kërkesat në zhvillim të tregut të punës. Njohuritë e marra nga këto punëtori do të shërbejnë si një katalizator për përmirësime të vazhdueshme në kurrikulat e universiteteve, duke siguruar që të diplomuarit janë të pajisur mirë për t'iu përgjigjur sfidave të peisazhit profesional.



Figura 4: Punëtorja e Panelit Korporativ në Fakultetin e Agrobiznesit, Universiteti i Pejës